

V E N D I M

Nr.298, datë 24.6.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.354,
DATË 29.8.1994 "PËR SHPËRBLIMIN E CILËSISË SË VEPRIMTARIVE SPORT-
IVE PËR SPORTISTËT, TRAJNERËT E GJYQTARËT DHE SHPËRBLIME TË
TJERA PËR VEPRIMTARITË SPORTIVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në lidhjen nr.5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.354, datë 28.8.1994 bëhen
këto ndryshime:

- Paragrafi I ndryshohet si vijon:
"Shpërblimi i gjyqtarëve dhe vëzhguesve të futbollit deri në 2 000 (dy mijë) lekë."
 - Paragrafi IV ndryshohet si vijon:
"Shpërblimi i trajnerëve joefektivë, për orën mësimore deri në 200 (dyqind) lekë".
 - 2. Efektet financiare të përballohen brenda fondeve buxhetore të Ministrisë së Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve dhe nga të ardhurat, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë
9.7.1998 dhe udhëzimit të përbashkët nr.4, datë 18.12.1998.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko